



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: GJEOMORFOLOGJI

Pedagogu: Prof. Dr. Skënder Sala
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: me zgjedhje
Programi i studimit: bachelor
Viti/Semestri: III/I

EKSTRAKT

Gjeomorfologjia është lëndë me zgjedhje dhe ka qëllim të plotësojë njohuritë e arkeologëve të rinjë në drejtim të njohjes e vlerësimit të territorit, kryesisht morfologjisë së tij : format kryesore të relievit, veprimin e shkallës së proceseve modeluese aktuale mbi këto forma, llojet e shkëmbinjve sipërfaqësorë në terrenin konkret, përdorimin e territorit nga njeriu dhe ndikimi kësaj veprimtarie ekonomike mbi elementet kryesore mjedisor. Njeriu shikohet si nje faktor morfologjik i rëndësishëm në morfologjinë e relievit, nxitjen, ngadalësimin e proceseve modeluese aktuale, etj. Në këtë cikël leksionesh semestral do t'i jepet rendësi të njohjes, vlerësimit të formave të relievit, shkëmbinjve sipërfaqësor, proceset modeluese aktuale në terren. Kjo do realizohet me prë mësimore në terren përreth Tiranës. Aty do të diskutohet konkretisht e në varësi të temave kryesre, sidomos morfologjisë, llojet të shkëmbinjve sipërfaqësor, qëndrueshmëria e tyre ndaj faktorëve të jashtëm, mundësia e përdorimit të tyre nga njeriu, erozionit, rrëshqitjeve, shëmbjeve, rrëzimeve, morfometrisë së shpateve dhe rëndësisë tyre për vendbanimet e veprimtarinë ekonomike të banorëve, etj.

Vend të rëndësishëm do të zërë puna me hartën topografike, sidomos lezimi hartës në shkallën 1 :25 000, shenjat e simbolet e ngjyrat, koordinatat gjeografike, orientimi, llogaritja e treguesve morfometrik kryesore të relievit nga harta, matjet dhe gjetja e lartësive, pjerrësive në hartë, etj.

Gjithashtu do shikohet mundësia e vlerësimit konkret të një vendbanimi të hershëm e të ri (p.sh. Petrela), duke i mëshuar pozitës gjeografike, morfologjisë së relievit, shmanjja e rreziqeve natyrore, qëndrueshmëria e truallit, shkëmbinjte e përdorur në ndërtime, shpatet dhe mundësitë për bujqësi-blektori, burimet ujore dhe faktorët që i kushtëzojnë etj ; përdorimin e tokës, peizazhi rural, nikimi njeriut, etj.

Këto njohuri e ndihmojnë studentin të mund të bëhet më i sigurtë gjatë gërmimeve arkeologjike sa i përket vlerësimit tërësor të objektit në lidhjen natyrë-njeri, të shpjegojë rastet kur materiali arkeologjik i objektit gjëndet edhe hipsometrikisht shumë më poshtë tij, etj.

TEMAT:

LEKSION 1. Gjeomorfologjia shkencë që studion morfologjinë e jashtme të tokës.

LEKSION 2. Shkëmbinjë kryesorë në truallin shqiptar: grupet dhe formimi dhe mosha e tyre.

LEKSION 3. Qëndrueshmëria e shkëmbinjve ndaj faktorëve modelues, veti-fiziko-kimike: përdorimi tyre nga njeriu. Praktikë në terren.

LEKSION 4. Lidhja e varësia midis njeriut e natyrës : ndikimet e veprimtarisë ekonomike e pasojat mbi morfologjinë e territorit. Vëzhgim në terren.

LEKSION 5. Hartat : klasifikimi sipas kriterëve shkencore e shkallëve, hartat tematike, gjeomorfologjike, etj.; përdorusit e tyre.

LEKSION 6. Orientimi dhe leximi hartave të shkallëve 1 :25 000 : shenjat e simbolet... ; punë praktike

LEKSION 7. Matjet e largësive në hartë sipas shkallës së hartës: punë praktike.

LEKSION 8. Llogaritjet të disa treguesve morfometrikë të relievit nga harta topografike 1 :25 000.

LEKSION 9. Forma e shpateve, klasifikimi e mundësia e përdorimit nga njeriu.

LEKSION 10. Proceset gjeomorfologjike të shpatit : Rrëshqitjet. Praktike në terren.

LEKSION 11. Proceset gjeomorfologjike të shpatit : shëmbjet, rrëzimet. Praktikë në terren.

LEKSION 12. Erozioni sipërfaqësor dhe abrazioni detar, ndikimi në përdorimin e tokës dhe vendbanimeve : Praktikë në terren.

LEKSION 13. Mbrojtja e siteve gjeomorfologjike nga rreziqet natyrore gjeomorfologjike.

LEKSION 14. Përdorimi tokës dhe arkeologjia: territori e toponimet, bonifikimet, peizazhi agrar, vendbanimet, qeramika rastësore; hartat tematike të domosdoshme për hartën e përdorimit të tokës.

LEKSION 15. Shlyerja e detyrimeve përfundimtare

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 15 javëve të semestrit :komente dhe interpretime.
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjeshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

LIRËZA Q. GJEOMORFOLOGJIA. TEKSTMËSIMOR UNIVERSITAR, TIRANË 2013

Sala S &Lirëza Q. Vendbanimet e Tomoricës. Tiranë, 2014

Sala S. Planifikimi e rregullimi i territorit. Tiranë, 2008

Sala S., etj. Proçeset dhe format aktuale gjeomorfologjike të brezit bregdetar në sektorin kepi i Lagjit - bishti i Pallës. Studime gjeografike, nr. 10, Tiranë, 1997

Sala S. Gjeomorfologjia e aplikuar dhe shfrytëzimi i mjedisit. Konferenca II-të e Gjeografisë. Shkodër, 1995